

RAPORTI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË RREGULATIVËS

Emri i ministrisë	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Emri i propozim ligjit:	Propozimi i Ligjit për shpalljen e Mavrovës për zone të mbrojtur në kategorinë e parkut kombëtarë, me procedure të shkurtuar
Personi përgjegjës dhe kontakt informatat:	Jadranka Ivanova, sektori i BE-së Vlatko Tërpeski, udhëheqës i Sektorit të Natyrës
Lloji i raportit	<input checked="" type="checkbox"/> Draft <input type="checkbox"/> Propozimi
Detyrimi i përgatitjes së propozimit të ligjit del nga:	<input type="checkbox"/> Programi vjetor i punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë <input type="checkbox"/> NPAA <input type="checkbox"/> Konkluzioni Qeverisë së Republikës së Maqedonisë <input checked="" type="checkbox"/> Të tjera _____
Lidhshmëria me Direktivat e BE-së	Direktiva për ruajtjen e vendbanimeve natyrore dhe flora dhe fauna e egër (92/43/EEC) Direktiva për ruajtjen e shpezëve të egra (2009/147/EC)
A mban draft raporti informata në pajtim me rregullat të cilat kanë të bëjnë me informatat e klasifikuara	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo
Data e shpalljes së draft Raportit të ENER:	02.2015
Data e dorëzimit të draft Raportit te Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata:	
Data e marrjes së mendimit nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata:	
Afati i dorëzimit të propozim ligjit te Sekretarijati iPërgjithshëm	

1. Përshkrimi i gjendjes në sferën dhe definimin e problemit

1.1 Përshkrimi i gjendjes

Parku Kombëtarë Mavrova për here të pare për zonë të mbrojtur u shpall në vitin 1949 me dekretin e Asamblesë popullore të RPM, për shkak të bukurive të veçanta natyrore, njohurive shkencore dhe historike të maleve dhe peisazheve malore rreth Fushës së Mavrovës..

Me Ligjin për ndryshimin e Ligjit për shpalljen e peisazheve malore reth Fushës së Mavrovës për park kombëtarë, të miratuar në vitin 1952 sipërfaqja e përkut kombëtarë është rritur për gjashtë here përkatësisht nga 11,750 ha në 73,088 ha.

Duke marrë parasysh vend ndodhjen karakteristike, bukuritë e veçanta natyrore, vlerat e peisazhit dhe vlerat estetike, bota bimore dhe shtazore jashtëzakonisht e pasur dhe endemike, Mavrova i përmbush kriteret që të shpallet zone e mbrojtur në kategorinë –park kombëtarë.

Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurën e shpalljes së një zone të re të mbrojtur Mavrovë, por e njëjta sërish shpallet për zonë të mbrojtur në kategorinë e II-të – park kombëtarë, në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së Natyrës.

Në pajtim me nenin 92 paragrafin (5) të këtij ligji, me qëllim të përcaktimit të gjendjes reale dhe sigurimit të bazës profesionale për hartimin e aktit të shpalljes së zonës së mbrojtur, është përpunuar Studimi për vlerësimin e zones së mbrojtur Mavrovë.

Procedura për shpalljen e Mavrovës për zonë të mbrojtur në kategorinë e parkut kombëtarë ka filluar në bazë të analizës së kryer shkencore të vlerave natyrore të Mavrovës, rekomandimet për propozim kategorinë e zonës së mbrojtur Mavrovë, kufijtë(zonat) e jashtme të propozuara dhe të mbrendëshme të propozuara , që përfshihen në Studimin e vlerësimit të zonës së mbrojtur Mavrovë (2011).

1.2 Shkaqet e problemeve të cilat janë lëndë e shqyrtimit

Në pajtim me nenin 187 paragrafi 1 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 67/2004, 14/2006, 84/2007, 35/10, 47/11, 148/11, 59/12, 13/13, 163/13 dhe 41/14), Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka për obligim që të bëjë vlerësimin e zonave të mbrojtura, të mbrojtura para ditës së fillimit të zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe të përgatisë akte të reja për shpalljen, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Në pajtim me nenin 92 paragrafin 1 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, parqet këmbëtare shpallen për zona të mbrojtura me ligj.

Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e njëqind e tridhjetë e shtatë të mbajtur më 28.05.2013 e shqyrtoi Informatën për nevojën e rishpalljes së Mavrovës për zonë të mbrojtur në kategorinë e parkut kombëtarë dhe solli konkluzionin

me të cilin e miratoi Vendimin për pranueshmërinë e propozimit për rishpalljen e Mavrovës për zonë të mbrojtur në kategorinë –park kombëtarë.

2. Qëllimet e propozim rregulativës

Qëllimet të cilat pritet që të arrihen me sjelljen e Ligjit për shpalljen e Mavrovës për park kombëtarë janë:

- përmbushja e kushtit nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
- përmirësimi imbrojtjes ligjore për menaxhimin me Parkun Kombëtarë Mavrova
- mirëmbajtja dhe rregullimi i parkut kombëtarë , me qëllim të mbrojtjes së natyrës përmes mbrojtjes së llojllojshmërisë biologjike dhe të peisazhit dhe trashëgimisë natyrore
- ruajtja e vlerave natyrore, kulturore dhe vlerave të tjera
- krijimi i kushteve më të volitshme për mirëmbajtjen, zhvillimin dhe avancimin e vlerave natyrore;
- parandalimin e çfarëdo veprimeve me të cilat me ndërmjetësim ose drejtpërdrejt mund të ndryshohet gjendja dhe zhvillimi natyror i vlerave natyrore dhe
- rregulimi i raportit të njeriut drejt natyrës.

3. Zgjidhjet e mundëshme (opcionet)

3.1 përshkrimi i zgjidhjes „mos bëj asgjë“

Zgjidhja „mos bën asgjë “ – Nëse nuk sillet Ligji për shpalljen e Mavrovës për park kombëtarë nuk do të përmbushen dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, si dhe qëllimet e lartpërmendura të rregulativës. Për këtë arsye nuk do të mundet që të vendoset menaxhimi funksional dhe i qëndrueshëm me parkun kombëtarë Mavrova dhe nuk do të mund të sillen dokumentet zhvillimore për punën e Institucionit Publik –Parku Kombëtarë Mavrova.

3.2 Përshkrimi i zgjidhjeve të mundëshme (opcioneve) për zgjidhjen e problemit

Opcioni: TË SILLET Ligji për shpalljen e Mavrovës për park kombëtarë, me të cilin do të sigurohet harmonizimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe do të avancohet mbrojtja dhe menaxhimi i vlerave natyrore të Parkut Kombëtarë Mavrova. Me sjelljen e Ligjit për shpalljen e Mavrovës për park kombëtarë do të sigurohet mbrojtja më e mire ligjore dhe do të krijohen kushte për sjelljen e dokumenteve zhvillimore për punën e Institucionit Publik Parku Kombëtarë – Mavrovë. Me sjelljen e ligjit do të përmirësohet mbrojtja fizike e vlerave natyrore të parkut kombëtarë - Mavrova dhe do të vendoset caktimi i zonës përkatëse të parkut në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

4. Vlerësimi i ndikimeve të rregulativës

Ndikimet e mundëshme negative dhe positive nga secili opcion:

Opcioni „mos bëj asgjë“

4.1 *Ndikimet e konomike*

Nuk ka ndikime positive dhe negative

4.2 *Ndikimet fiskale*

Nuk ka ndikime positive dhe negative

4.3 *Ndikimet sociale*

Nuk ka ndikime positive dhe negative

4.4 *Ndikimet ndaj mjedisit jetësor*

Do të ndikojë negativisht në zbatimin e legjislacionit nga sfera e mbrojtjes së natyrës

4.5 *Ndikimet dhe shpenzimet administrative –*

a) shpenzimet për zbatim

Nuk ka ndikime positive dhe negative

b)shpenzimet për respektimin e rregulativës

Nuk ka ndikime positive dhe negative

Opcioni 1 – Miratimi i Ligjit për shpalljen e Mavrovës për park kombëtarë

4.1 *Ndikimet ekonomike*

Përmirësimi i gjendjes ekonomike i Institucionit Publik Parku Kombëtarë Mavrova dhe i popullsisë lokale, përmes realizimit të disa veprimtarive dhe aktiviteteve në parkun kombëtarë Mavrova.

4.2 *Ndikimet fiskale*

Priten ndikime positive mbi gjendjen financiare të Institucionit Publik Parku Kombëtarë Mavrova, përmes sigurimit të mjeteve të parapara me arkëtimin e kompenzimeve, në pajtim me nenin 141-a të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës

4.3 *Ndikimet sociale*

Përmirësim në rolin e banorëve lokal në menaxhimin e Parkut Kombëtarë të Mavrovës.

4.4 *Ndikimet ndaj mjedisit jetësor*

Përmirësimi i mrojtjes dhe menaxhimit me vlerat natyrore të Parkut Kombëtarë Mavrova.

4.5 *Ndikimet dhe shpenzimet administrative –*

a) shpenzimet për zbatim

Zgjidhjet e propozuara në Propozim Ligjin nuk do të shkaktojnë shpenzime për zbatimin e tyre

b) shpenzimet për respektimin e rregullatës

Shpenzimet për respektimin e zgjidhjeve të parapara, të përfshira në propozim ligjin, do të jenë barrë e Institucionit Publik të Parkut Kombëtarë- Mavrova

5. **Konsultimet**

5.1 *Palët e tanguara dhe mënyra e përfshirjes*

Qeveria e RM, Kabineti i zëvendës kryeministrit për çështje ekonomike
Ministria e Financave
Sekretariati i Legjislacionit
Sekretariati për Çështje Evropiane
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministria e Ekonomisë
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Ministria e Kulturës, Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
Agjencia e Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kadastrit të Patundshmërive
Agjencia e Promovimit dhe Mbështetjes së Turizmit
Komuna e Mavrovës-Rostushës
Komuna e Gostivarit
Komuna e Dibrës
Institucioni Publik -Parku Kombëtarë Mavrova
Fakulteti Matematiko-Natyrorë, Instituti i Biologjisë
Fakulteti i Pylltarisë, Shkup
Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit, Shkup
Muzeu Natyror-Shkencor i Maqedonisë, Shkup
SHA ELEM

Organizatat joqeveritare :

Shoqata për Studimin dhe Mbrojtjen e Biodiversitetit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Ekosistemeve Natyrore (BIOEKO), Shkup
Shoqata për Studimin dhe Mbrojtjen e Zogjëve të Maqedonisë, Shkup
Shoqata Mikologjike Maqedonase, Shkup
Shoqata për Mbrojtjen e Natyrës në Maqedoni, Shkup
Shoqata Ekologjike Maqedonase (SHEM)
OJQ - Fronti 21/42, Shkup
OJQ – Eko-svest(Eko-vetëdija), Shkup

5.2 Pasqyrë e mendimeve të marrura dhe të inkorporuara

Mendimet e marrura nga institucionet shtetërore do të inkorporohen në tekstin e ligjit

5.3 Mendimet të cilat nuk do të merren parasysh dhe pse

Të gjithë mendimet e dorëzuara janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar në tekstin e ligjit

6. Përfundimi dhe zgjidhja e rekomanduar

6.1 Pasqyra krahasuese e ndikimeve të mundëshme negative dhe positive e zgjidhjeve të mundëshme (opcione)

Opcioni „mos bëj asgjë“ është i papranueshëm, sepse me mos miratimin e Ligjit për Shpalljen e Mavrovës për Park Kombëtarë nuk do të përmbushen dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, si dhe qëllimet e rregulativës. Për këtë shkak nuk do të vendoset menaxhimi funksional dhe i qëndrueshëm me Parkun Kombëtarë Mavrova dhe nuk do të mund të sillen dokumentet zhvillimore për punën e Institucionit Publik –Parku Kombëtarë Mavrova.

6.2 Rreziqet në zbatimin dhe realizimin e çdo zgjidhjeje të mundëshme (opcionit)

Nuk ka

6.3 zgjidhje e rekomanduar me arsyetim

Të miratohet Ligji për Shpalljen e Mavrovës Park Kombëtarë, me të cilin do të sigurohet harmonizimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe do të avancohet mbrojtja dhe menaxhimi me vlerat natyrore të parkut kombëtarë Mavrova. Me miratimin e ligjit do të sigurohet mbrojtja më e mire ligjore dhe do të krijohen kushte për sjelljen e dokumenteve zhvillimore për punën e Institucionit Publik - Parku kombëtarë Mavrova. Me miratimin e ligjit do të përmirësohet mbrojtja fizike

e vlerave natyrore të Parkut kombëtarë –Mavrova dhe do të vendoset zonimi përkatës i parkut, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

7. Zbatimi i zgjidhjes së rekomanduar

7.1 Nevoja e ndryshimit të ligjeve dhe rregulativës nëligjore në këtë sferë ose në sfera të ngjashme

Nuk ka, sepse bëhet fjalë për Ligjin e Shpalljes së Zonës së Mbrojtur për sjelljen e të cilit baza ligjore është përfshirë nëLigjin e Mbrojtjes së Natyrës .

7.2 Aktet nëligjore të nevojshme dhe afati i miratimit të tyre

Nuk ka nevojë që të miratohen akte nëligjore

7.3 Organet e administrates shtetërore,organet shtetërore dhe organet e tjera kompetente për zbatim

Në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së Natyrës, Institucioni Publik -Parku Kombëtarë Mavrova është kompetent për menaxhimin dhe mbrojtjen e parkut kombëtarë Mavrova.

Mbikqyrjen mbi menaxhimin dhe mbrojtjen e Parkut Kombëtarë –Mavrova si dhe mbikqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji e kryen organi i administrates shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës (Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor)

Mbikqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji e kryen Inspektorati Shtetërorë i Mjedisit Jetësor, permes inspektorëve shtetërorë të mbrojtjes së natyrës..

7.4 Aktivitetet për sigurimin e zbatimit efikas të propozim ligjit

Me miratimin e Ligjit për Shpalljen e Mavrovës për Park Kombëtarë do të mundësohet vendosja e zonimit përkatës të parkut, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së Natyrës dhe sjelljes së Planit të përgatitur për menaxhimin me Parkun Kombëtarë Mavrova.

8. Vëzhgimi dhe vlerësimi

8.1 Mënyra e vëzhgimit të zbatimit

Vëzhgimi dhe zbatimi i ligjit bëhet permes mbikqyrjes ndaj menaxhimit dhe mbrojtjes së Parkut Kombëtarë Mavrova dhe zbatimit të dokumenteve zhvillimore, Planit të Menaxhimit dhe Programeve Vjetore për Mbrojtjen e Natyrës..

8.2 Vlerësimi i efekteve nga propozim ligji dhe afatet

Miratimi dhe zbatimi i Planit për Menaxhimin me Parkun Kombëtarë – Mavrova dhe Programet Vjetore për Mbrojtjen e Natyrës.

Deklarata e sekretarit shtetëror

Draft Raporti i vlerësimit të ndikimit të rregulativës është përgatitur në pajtim me Metodologjinë e vlerësimit të ndikimit të rregulativës. Ai jep një vlerësim real të ndikimeve të mundëshme dhe të efekteve të pritura, si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me çdo zgjidhje të mundëshme të përcaktuar (opcione) për zgjidhjen e problemit.

Data: .02.2015

nënshkrimi i sekretarit shtetëror

Dr. Sonja Lepitkova

Deklarata e minisrit

Në bazë të rezultateve të analizave të shprehura në Raportin e vlerësimit të ndikimit të rregulativës mendoj se zgjidhja e rekomanduar (opcion) paraqet mënyrën më të mire të zgjidhjes së problemit dhe arritjes së efekteve të pritura në mënyrë më ekonomike.

data: .02.2015

Nurhan Izairi

nënshkrimi i ministrit

**Udhëzim për plotësimin e
RAPORTIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË RREGULATIVËS**

Emri i ministrisë :	<i>Vendoset emri i ministrisë</i>
Emri i propozim ligjit:	<i>Vendoset emir i propozim ligjit</i>
Personi përgjegjës dhe kontakt informacionet:	<i>Vendoset emri dhe mbiemri dhe informacionet për kontakt të drejtuesit të sektorit përkatësisht kryetarit të grupit punues përgjegjës për zbatimin e VNR për propozim ligjin konkretë</i>
Lloji i Raportit	<input type="checkbox"/> Projekt - <i>Shënohet “projekt“ kur ministria kompetente e dorëzon projekt raportin për VNR te Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë për mendim. Projekt Raportin e nënshkruan sekretari shtetëror i ministrisë</i> <input type="checkbox"/> Propozim - <i>shënohet “propozim“ kur ministria kompetente e dorëzon propozim Raportin te Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Propozim Raportin e nënshkruan ministri</i>
Detyrimi për përgatitjen e propozim ligjit del nga:	<i>Shënohet përgjigja e përzgjedhur</i> <input type="checkbox"/> program vjetor për punën e qeverisë së Republikës së Maqedonisë <input type="checkbox"/> NPAA <input type="checkbox"/> Konkluzioni i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë <input type="checkbox"/> Tjera_____
Lidhshmëria me direktivat e BE-së	<i>Nëse më lartë është shënuar përgjigja NPAA, theksohet Direktiva konkrete /dhe me të cilën kryhet harmonizimi</i>
Vallë projekt raporti përmbanë informata në pajtim me parimet që kanë të bëjnë me informatat e klasifikuara	<i>Shënohet përgjigja e zgjedhur</i> <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
Data e publikimit të projekt Raportit të ENER-it	<i>Theksohet data e publikimit të projekt Raportit të ENER</i>

Data e dorëzimit të projekt Raportit të Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata:	<i>Theksohet data e propozim Raportit të Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata</i>
Data e marrjes së mendimit nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata:	<i>Theksohet data e marrjes së mendimit nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata</i>
Afati i dorëzimit të propozim ligjit të Sekretarijati i Përgjithshëm	<i>Theksohet data /afati i dorëzimit të propozim ligjit të Sekretarijati i përgjithshëm</i>

1. Përshkrimi i gjendjes në këtë sferë dhe definimi i problemit

1.1 Përshkrimi i gjendjes

(Jepet përshkrimi i gjendjes në këtë sferë duke përfshirë edhe rregulativën valide në këtë sferë ose sfera të tjera të ndërlidhura, si dhe programe/projekte të tjera të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të cilat zbatohen)

1.2 Shkaqe për problemet të cilat janë lëndë e shqyrtimit

(po sqarohen arsytet për problemet të cilat janë lëndë e shqyrtimit (jo vetëm simptomat)

2. Qëllimet e propozim rregullativës

(Theksohen qëllimet e pritura/të dëshiruara dhe efektet të cilat propozim rregullativa duhet të arrijë)

3. Zgjidhjet e mundëshme (opcionet)

3.1 Përshkrimi i zgjidhjes „mos bëj asgjë“

(shpjegohet gjendja „mos bëj asgjë“, përkatësisht jepet përshkrimi i pasojave nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë nuk intervenon me propozim ligjin ose ndonjë masë tjetër)

3.2 Përshkrimi i zgjidhjeve të mundëshme (opcioneve) për zgjidhjen e problemit

(theksohen zgjidhjet e mundëshme (opcionet) për zgjidhjen e problemit që janë shqyrtuar gjatë procesit të VNR. Gjatë kësaj përmbajtja e opcioneve dhe mënyra e zbatimit të zgjidhjeve të mundëshme përkatësisht përmes miratimit të një ligji të ri, ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji (masa rregulluese); zbatimi i trajnimeve, fushatave dhe aktiviteteve të ngjashme (masa joregulluese) ose kombinimi i masave (regulluese dhe joregulluese)).

4. **IVlerësimi i ndikimeve të rregullativës**

Jepet përshkrim i hollësishëm i ndikimeve pozitive dhe negative që mund të dalin nga secili opcion edhe atë për:

4.1 Ndikimet ekonomike

(përshkruhen përfitimet dhe shpenzimet për ekonominë në këtë sferë, punësimi dhe konkurrenca. Sidomos duhet të përshkruhen ndikimet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, subjektet ekonomike, shpenzuesit, amvisëritë e të tjerë.)

4.2 Ndikimet fiskale

(Përshkruhen shpenzimet dhe përfitimet për buxhetin, pasqyra e shpenzimeve inicuese dhe projektuese, si dhe informacioni për atë se a janë siguruar mjete në buxhetin, jepet një rezime nga Formulari i ndikimeve fiskale)

4.3 Ndikimet sociale

(Përshkruhen ndikimet mbi zvogëlimin e varfërisë, mbrojtjen dhe avancimin e shëndetsisë , mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut dhe i barazisë gjinore, mbrojtja e grupeve të ndjeshme dhe të pafavorizuarve e të tjera.)

4.4 Ndikimet ndaj mjedisit jetësor

(përshkruhen ndikimet ndaj cilësisë së ajrit, ujit, tokës, efekti i serrave, zhurma, biodiversiteti e të tjera. Jepet përshkrimi se si ndikimet ndaj mjedisit jetësor do të ndikojnë drejtpërdrejt ose indirekt ndaj shëndetit të njerëzve.)

4.5 Ndikimet administrative dhe shpenzimet -

a) shpenzimet e zbatimit

(theksohen shpenzimet për zbatimin e propozim ligjit - formimi i institucioneve/organeve të reja ose zgjerimi i kompetencave dhe organizimi i organeve ekzistuese, resurset e nevojshme njerëzore dhe trajnimi i tyre, investimet (ambienti i zyrave), mbikqyrja e nevojshme, pajisja e të tjera.)

b) shpenzimet për respektimin e rregullativës

(përmenden shpenzimet për respektimin e rregullativës -vendosjen e mbingarkimeve të reja administrative, formalitetet dhe shpenzimet (liçenca, leje, informacione, standarde) për personat juridik dhe/ose fizik dhe se si do të shprehet kjo mbi konkurrencën)

5. **Konsultimet**

5.1 Palët e tanguara dhe mënyra e kyçjes

(theksohen palët e tanguara të cilat ishin konsultuar gjatë procesit dhe mënyrat e konsultimit/kyçjes së tyre)

- 5.2 *Pasqyra e mendimeve të marrura dhe të inkorporuara
(jepet pasqyra e mendimeve të marrura me theks të atyre çështjeve që kanë shkaktuar një interes ose brengë të posaçme të palët e tanguara.(Përmenden se cilat mendime janë marrë parasysh)*
- 5.3 *mendimet që nuk janë marrë parasysh dhe pse
(përmenden mendimet të cilat nuk janë marrë parasysh dhe me arsyetimin për shkaqet për këtë)*

6. Konkluzionet dhe zgjidhjet e rekomanduara

- 6.1 *pasqyrë comparative e ndikimeve pozitive dhe negative të zgjidhjeve të mundëshme (opcione)
(jepet përshkrim komparativ i anëve ose ndikimeve positive dhe negative i zgjidhjeve të mundëshme (opcione))*
- 6.2 *rreziqet në zbatimin dhe realizimin e secilës zgjidhje të mundëshme opcione)
(përshkruhen rreziqet në zbatimin dhe realizimin e çdo zgjidhje të mundëshme (opcione))*
- 6.3 *zgjidhje e rekomanduar me arsyetim
(Përshkruhet zgjidhja e rekomanduar me arsyetimin pse po rekomandohet)*

7. Zbatimi i zgjidhjes së rekomanduar

- 7.1 *nevoja për ndryshimin e ligjeve dhe rregullativës nëligjore në këtë sferë ose sfera të tjera si motra
(përmendet se vallë zgjidhja e rekomanduar do të shkaktojë nevojën e ndryshimit të ligjeve dhe rregullativës nëligjore në këtë sferë ose sfera të tjera si motra.)*
- 7.2 *Aktet nëligjore të nevojshme dhe afati për sjelljen e tyre
(përmendet se vallë edhe cilat akte nëligjore duhet të sillen dhe afati i propozuar për sjelljen e tyre)*
- 7.3 *Organet e administratës shtetërore, organet shtetërore dhe organet e tjera kompetente për zbatim
(përmenden organet e administratës shtetërore, organet shtetërore dhe organet e tjera të cilat do të jenë kompetente për zbatim)*
- 7.4 *Aktivitetet për sigurimin e zbatimit efikas të propozim ligjit
(përmenden aktivitetet masat jorregulluese) që do të ndërmerren me qëllim të sigurimit të zbatimit efikas të propozim ligjit trajnimet, këshillat, fushatat etj.))*

8. Vëzhgimi dhe vlerësimi

8.1 mënyra e vëzhgimit të zbatimit

(përshkruhet shkurtimisht se si do të vëzhgohet zbatimi dhe arritja e efekteve nga rregullativa dhe cilët organe të administrates shtetërore do të kyçen në procesin e vëzhgimit)

8.2 Vlerësimi i efekteve nga propozimi i ligjit dhe afatet

(përshkruhet shkurtimisht si do të bëhet vlerësimi i efekteve nga rregullativa dhe në cilën periudhë kohore)

Deklarata e sekretarit shtetëror

Projekt Raporti i vlerësimit të ndikimit të rregulativës është përgatitur në pajtim me Metodologjinë e vlerësimit të ndikimit të rregullativës . Ai jep një vlerësim real të ndikimeve të mundëshme dhe efekteve të pritura, si dhe shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me çdo zgjidhje të mundëshme të përcaktuar (opcione) për zgjidhjen e problemit.

Data: _____

.....

Nënshkrimi i sekretarit shtetëror

(Sekretari shtetëror e nënshkruan deklaratën në draft raportin para se ministria kompetente t'ia dorëzojë draft Raportin për VNR, Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës për mendim.

Deklarata e ministrit

Në bazë të rezultateve nga analizat e shfaqura në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit të rregullativës, mendoj se zgjidhja e rekomanduar (opcion) paraqet mënyrën më të mire për zgjidhjen e problemit dhe arritjes së efekteve të pritura në mënyrën më ekonomike.

Data: _____

.....

Nënshkrimi i ministrit

(Ministri i ministrisë me resorë e nënshkruan deklaratën në propozim Raportin para se ministria komptente ta dorëzojë propozim Raportin te Sekretarijati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë).

